REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHERBIMIT SOCIAL
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL

Nr. Prot. **Bilisht më, . .2026**

PROJEKT-VENDIM

NR. 9, DATË 22/01/2026

"PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË STREHIMIT PER VITIN 2026"

Në mbështetje të neņit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54 shkronja "k", nenit 55, pika 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", nenit 2 pika 51, nenit 15, pika 5, të ligjit nr. 22/2018, "Për Strehimin Social" i ndryshuar;

PROPOZOJ:

1. Të ngrihet dhe funksionoje pranë Bashkisë Devoll, Komisioni i Strehimit.
2. Komisioni i Strehimit shqyrton dhe merr vendime ne lidhje me kërkesat e paraqitur nga çdo subjekt që kërkon për të përfituar nga njëri prej programeve sociale të strehimit, si dhe për çdo çështje tjetër që parashikohet nga legjislacioni për strehimin, çështje sociale apo nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore që përcaktojne shqyrtimin e kërkesave nga ky komision.
3. Komisioni i Strehimit ka përbërjen e mëposhtme:

- Drejtor I Shërbimeve Sociale, Shëndetësore dhe Strehimit - Kryetar komisioni.
- Përgjegjës i Sektorit të Kujdesit Social dhe PAK -Anëtar komisioni.
- Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit - Anëtar komisioni.
- Drejtor I Planifikimit të Buxhetit - Anëtar komisioni.
- Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike - Anëtar komisioni.
- Përfaqësues nga Shoqata e Romëve - Anëtar komisioni.
- Specialist e administrit për nevojat për strehim - Anëtar komisioni.
- Përgjegjës i emergjencave civile - Anëtar komisioni.

4. Komisioni i Strehimit asistohet nga një sekretariat administrativ, i cili asiston komisionin gjatë gjithë veprimtarisë së tij. Anëtarët e sekretariatit janë pjesë e Drejtorisë së Shërbimit Social dhe janë përgjegjës për:

a. Marrjen në dorëzim të aplikimeve dhe kërkesave që janë objek i shqyrtimit dhe vendimarrjes së Komisionit;
b. Shpërndan dhe vë në dispozicion të anëtarve, matërialet për mbledhjet e radhës, brenda 5 ditëve punë para datës së mbledhjes;
c. Njofton Kryetarin e komisionit për çdo kërkesë të paraqitur për shqyrtim dhe u njofton anëtarve datën e marrjes në shqyrtim të kërkesës/aplikimit;
d. Dhënien e mendimit kur i kërkohet nga komisioni, mendim i cili pasyrohet në procesverbalin e mbledhjes;
e. Mban, harton, dhe nënshkruan procesverbanlin e mbledhjes;
f. Zbardh vendimin e arsyetuar të marrë në mbledhjen e Komisionit;
h. Çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga kryetari apo komisioni i strehimit.

5. Ngarkohet Sektori i Kujdesit Social dhe PAK të kryej procedurat përkatëse për përzgjedhjen e anëtarit nga komunitetet e interesuara që duhet të jenë pjesë e këtij komisioni.
6. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë të miratojë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këtij komisioni.
7. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Komisioni i Strehimit, Sektori i Kujdesit Social dhe PAK, për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

Konceptoi: Specialiste për administrimin e nevojave për strehim
Linda Laçi

Konfirmoi: Përgjegjës i sektorit të Kujdesit Social
Marilda Bejleri

Miratoi: Drejtor i Shërbimeve Sociale, Shëndetësore dhe Strehimit
Zerina Sinani

Konfirmoi bazen ligjore:
Përgjegjëse e Sektorit Juridik
Eriksela Avdo

Konfirmoi: Sekretar i Përgjithshëm
Adriana Rushitaj

KRYETARI I BASHKISË
EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHERBIMIT SOCIAL
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL

Nr.291 Prot. **Bilisht më,22.01.2026**

RELACION

PËR PROJEKT- VENDIMIN

"PER NGRITJEN E KOMISIONIT TE STREHIMIT"

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54 shkronja "k", nenit 55, pika 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", nenit 2 pika 51, nenit 15, pika 5, të ligjit nr. 22/2018, "Për Strehimin Social" i ndryshuar, propozohet miratimi i komisionit te strehimit. "Komisioni i strehimit" është Komisioni që ngrihet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe ka në përbërje përfaqësues të komuniteteve të interesuar.

Komisioni i strehimit është komisioni që ngrihet me vendim të Këshillit Bashkiak dhe ka në përbërje përfaqësues të komuniteteve të interesuara. Kjo strukturë ka rolin që shqyrton, vlerëson dhe miraton procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Shërbimit Social përsa i përket shqyrtimit të kërkesave që individët/familjet kanë bërë për të qënë përfitues në programet e strehimit social, për t'i kaluar më tej për vendim-marje në Këshillit Bashkiak.
Komisioni i Strehimit asistohet nga një sekretariat administrativ, i cili administron punën e komisionit gjatë gjithë veprimtarisë së tij. Anëtarët e sekretariatit janë përgjegjës për:

a. Marrjen në dorëzim të aplikimeve dhe kërkesave që janë objekt i shqyrtimit dhe vendimmarrjes së Komisionit;
b. Shpërndan dhe vë në dispozicion të anëtarëve, materialet për mbledhjen e radhës, brenda 5 ditëve pune para datës së mbledhjes;
c. Njofton Kryetarin e komisionit për çdo kërkesë të paraqitur për shqyrtim dhe u njofton anëtarëve datën e marrjes në shqyrtim të kërkesës/aplikimit;
d. Dhënien e mendimit kur i kërkohet nga komisioni, mendim i cili pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes;
e. Mban, harton dhe nënshkruan procesverbalin e mbledhjes;
f. Zbardh vendimin e arsyetuar të marrë në mbledhjen e Komisionit;
g. Ruan konfidencialitetin.
h. Çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga Kryetari apo komisioni strehimit.